



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:080467  
Datë: 07.05.2024  
Numri i dokumentit: 05661751

**Ac.nr.32/2021**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dardan Kadolli, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Hunaida Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses M. Rr. nga Ferizaj rruga “H. S.”, nr...., të cilët e përfaqëson me autorizim R. S. avokat në Ferizaj, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve BKS, me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson me autorizim L. Rr., objekti i kontestit kompensim i dëmit, duke vendosur sipas ankesës së paditëses dhe të paditurës, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.825/17, datë 12.10.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 07.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**APROVOHET** e themeltë ankesa e të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve dhe e paditëses M. Rr., **PRISHET** Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.825/17, i datës 12.10.2020 dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm me aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.825/17, datë 12.10.2020, ka vendosur: *IMIRATOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëseve M. Rr. nga Ferizaj rruga “H. S.”, nr...., dhe DETYROHET e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve BKS, me seli në Prishtinë, që paditëseve t’ia kompensoj dëmin material dhe jo material për aksidentin e pësuar me datën 10.07.2017, me ç`rast paditësit kishin pësuar lëndime të rënda trupore, andaj duhet ti kompensohet dëmi në këto baza:*

a. *Në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material*

*- për të gjitha format e dhimbjeve fizike shumën prej.....8,200.00 €*  
*- për friken e përjetuar shumën prej .....2,000.00 €*

-për shëmtim trupor.....7, 000.00 €  
- për zvogëlim të aktivitetit jetësor –punues .....12,000.00 €

b. Në emër të kompensimit të dëmit material:

- për kujdesin nga personi i tretë në shumën prej .....800.00 €  
- për ushqim të përforcuar në shumën prej.....500.00 €  
- për shpenzime mjekësore në shumën prej.....4,310.00 €

Gjithsej dëmi jo material në shumë prej 35,260.00 €.

Gjithsej dëmi jo material dhe material për të gjithë të paditurit M. Rr., është aprovuar në shumën prej 35,260.00 €, (Tridhjetë e pesë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë euro). Të gjitha me kamate prej 8% duke llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë deri në pagesën përfundimtare, nën kanosjen e përmbarimit të dhunshëm.

II.REFUZOHET kërkesëpadia e paditëseve përtej shumave të gjykuara si në dispozitivin I dhe atë lidhur me kërkesën në emër të dhimbjeve fizike, ushqimit, ndihmës së huaj si dhe rehabilitimin fiziatriko-psikik në shumën prej 43,218.00 € (dyzetë tremijë e dyqind e tetëdhjetë euro) shpenzimeve për udhëtimin–biletë në shumën prej 2,340.00 €.

III.DETYROHET e paditura që në emrin e shpenzimeve të procedurës kontestimore dhe atë për taksën gjyqësore në shumën prej 21.00 €, përpilimin e padisë 208.00 €, për përfaqësim për 6 seanca gjyqësore nga 270.00 € x 6 = 1,620.00 €, për tri seanca e shtyra nga 135.00 x 3 – 405 për ekspertizat mjekësore shumën prej 900.00 € gjithsej për shpenzime gjyqësore shumën prej 2,749.00 €, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcnimit të përmbarimit të dhunshëm.

IV.OBLIGOHEN paditësit që të paguajnë shpenzimet për taksën gjyqësore shtesë në shumën prej 80.00 €, pas pranimit të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor kanë parashtruar ankesë e paditura, për shkaqe të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimi të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë ankesën si të bazuar, të kthej rastin në rigjykim. Ndër të metat që gjykata e shkallës së parë ka bërë, sipas pretendimeve në ankesë është se në aktgjykim fare nuk janë arsyetuar shkaqet se mbi bazën e cilave prova janë vërtetuar faktet e tilla. Po ashtu sipas tyre, gjykata ka vendosur shumën të larta të kompensimit, që janë në kundërshtim me praktikën e deritanishme që ka të bëjë me lartësinë e shumave kompensuese. Ka cekur se gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore, pasi që është bërë precizimi i kërkesëpadisë, nuk ka marrë aktvendim të posaçëm.

Paditësi përmes përfaqësuesit të tij, ka ushtruar ankesë, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Ka propozuar që Gjykata e Apelit të aprovojë ankesën dhe të ndryshoj aktgjykimin shkallës së parë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka vlerësuar se:

- Ankesa e të paditurës dhe paditëses janë të themelta.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes të autorizuarit të tij, me datën 19.09.2017, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës, duke kërkuar kompensim e dëmit material dhe jo material, si pasojë e aksidentit të trafikut, i cili ka ndodhur me datën 1.07.2017 në rrugën Shtime-Lipjan. Dëmi kishte ndodhur kur aksidenti kishte ndodhur ndërmjet dy veturave shkaktohet aksidenti kurse paditësja ka qenë në cilësi të pasagjeres, e cila ka pësuar lëndime të rënda trupore.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave, si dhe vlerësimit të tyre, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, duke aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se janë administruar provat, duke përfshirë ekspertizat mjekësore, raportet nga kontrollet. Fillimisht ka arsyetuar se ndërmjet të palëve ndërgjyqese nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë, por vetëm lartësia e kërkesëpadisë. Me tej për sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë ka arsyetuar në emër të dhembjeve fizike e aprovoj kërkesën e paditëses shumen prej 8,200.00€, dhe e vlerësoi si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse paditësi sipas mendimit të ekspertit mjekësor ortoped-traumatolog, si pasojë e lëndimeve të marra, ka pasuar dhembje fizike. Në emër të frikës së pësuar gjykata e ka caktuar shpërblimin në shumen prej 2,000.00€, dhe ka vlerësuar si shpërblim të drejtë duke u nisur nga fakti se, sipas mendimit të ekspertes mjekësore të psikiatrisë, paditësi ka pësuar frikë me rastin e aksidentit. Në emër të kujdesit nga personi i tretë, gjykata e ka caktuar shpërblimin në shumen prej 800.00 €, dhe ka vlerësuar si shpërblim të drejtë duke u nisur nga fakti se, paditësi ka pasur nevojë për ndihmën e personit të huaj në kohëzgjatje prej 40 ditë. Në emër të ushqimit të përforcuar, gjykata e ka caktuar shpërblimin në shumen prej 500.00 €, dhe ka vlerësuar si shpërblim të drejtë duke u nisur nga fakti se, paditësi ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 70 ditë. Në emër të rehabilitim klimatrik , gjykata e ka caktuar shpërblimin në shumen prej 450.00 €, dhe ka vlerësuar si shpërblim të drejtë duke u nisur nga fakti se, paditësi ka pasur nevojë për rehabilitim klimatrik në kohëzgjatje prej 90 ditë. Në emër të shëmtimi trupor në shkallë të mesme, gjykata e ka caktuar shpërblimin në shumen prej 7,000.00 €, dhe ka vlerësuar si shpërblim të drejtë duke u nisur nga fakti se, paditësi ka pasur shëmtim trupor në shkallë të mesme. Në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor 28.75 %, gjykata e ka caktuar shpërblimin në shumen prej 7,000.00 €, dhe ka vlerësuar si shpërblim të drejtë duke u nisur nga fakti se, paditësi ka pasur zvogëlim të aftësisë punuese në shkallë prej 28,75 %.

Ndërsa për sa i përket pjesës refuzuese të kërkesëpadisë, ka dhënë vlerësimin se shumat me të larta se ato të gjykuar me arsyetim se kërkesat e tillë të paditëseve nuk ka mbështetje në vlerësimin real të dëmit jo material, me faktin se gjykata nuk gjeti prova se shuma e refuzuar ti aprovoj andaj për këtë ka vendosur si në piken III. të dispozitivit të aktgjykimit. Në fund ka arsyetuar kamatën dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata e Apelit nuk mund t'i pranojë si të rregullta dhe të ligjshme, për arsye se aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore nga neni 182 paragraf 2, pika (n) i LPK-së, lidhur me nenet 182.1 dhe 160 të LPK-së, meqë ka të meta që nuk mund të ekzaminohen, ndërsa faktet vendimtare nuk janë vërtetuar dhe arsyetuar në masën e duhur dhe të mjaftueshme, për çka edhe është bërë vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike, si rezultat i së

cilës nuk është bërë zbatim i duhur i të drejtës materiale për të cilën shkelje gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, fillimisht i vlerëson si të bazuara pretendimet ankimore të paditurit se arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar është marrë më shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika n) të LPK-së, pasi që dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten dhe arsyet e dhëna në aktgjykim, i njëjti nuk përmban arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare dhe vlerësimin se në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri te përfundimi mbi themelësinë e kërkesëpadisë. Më tej kjo gjykatë ka arritur në përfundim se gjithashtu dispozitivi dhe arsyetimi i aktgjykimit të shkallës së parë nuk janë të formuluar konform nenit 160 të LPK-së, që përcakton strukturën dhe përmbajtjen që duhet ta ketë një vendim gjyqësor për të qenë i drejtë dhe i ligjshëm. Në këtë kuptim, për shkak të paqartësive të shumta që hasen në të, që lidhen me disa nga rrethanat kyçe faktike e juridike që e karakterizojnë këtë kontest juridiko-civil.

Duke vlerësuar vendimin e shkallës së parë, bazuar në pretendimet ankimore, gjithashtu kjo gjykatë ka ardhë në përfundim se gjykata e shkallës së parë ka vendosur lidhur me kërkesëpadinë, pa qenë e rregulluar (precizuar) siç duhet në kuptimin formalo juridik. Nga analizimi i procesverbaleve, vërehet se precizimi është bërë me rastin e dhënies së fjalës përfundimtare, që nuk është në pajtim me nenin 258 të LPK-së. Pas çdo propozimi për ndryshim të padisë, i cili bëhet në fazë të avancuar të procedurës, gjykata duhet të ofrojë mundësinë palës së paditur të deklarohet për një ndryshim të tillë, më pas të merr aktvendim për lejimin apo jo të ndryshimit të padisë, nga analiza e rastit kontestues arrihet në përfundim se nuk është vepruar në këtë mënyrë.

Në dispozitiv të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë ka njohur paditëses kompensimin për shpenzime mjekësore në lartësi prej 4,310€, kurse mënyra e llogaritjes së këtyre shpenzimeve mjekësore, nuk është në përputhje me gjendjen faktike të vërtetuar. Kjo kategori dëmi, përbën dëm material i cili duhet të provohet për ekzistencën dhe lartësinë e tij. Me qëllim llogaritjen e të njëjtës, gjykata duhet të administroj prova që ndërgjyqësit propozojnë, të vlerësoj nëse shpenzimet e tilla i përgjigjen mjekimit të ka pranuar pala, më pas të vendos për lartësinë.

Përveç të metave të lartcekura, Gjykata e Apelit të Kosovës, i vlerëson si të bazuara pretendimet ankimore në lidhje me konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ngase e njëjta nuk i ka vërtetuar të gjitha faktet vendimtare, e që si rrjedhojë ka pasur edhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, për të cilën gjykata e shkallës së dytë kujdeset edhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së. Shkeljet e tilla konsistojnë në faktin se gjykata e shkallës së parë ka vendosur për kategorinë zvogëlim i aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe zvogëlimit të aktivitetit punues në një vend, duke mos sqaruar mjaftueshëm së për cilën kategori bëhet fjalë, ky vlerësim vie nga fakti se behët fjalë për dy kategori të ndryshme kompensuese, e jo një siç ka vendosur në mënyrë jo të qartë gjykata e shkallës së parë.

Si rrjedhojë, për shkak të mangësive të evidentuara më lartë, e që i referohen shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se nuk janë krijuar kushtet ligjore që të mund të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, por është dashur që të priset aktgjykimi i atakuar dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe vendosje.

Bazuar në arsyet e paraqitura, aprovohen si të bazuara pretendimet ankimore lidhur me këto shkelje dhe me rastin e marrjes së lëndës në rishqyrtim dhe rivendosje, gjykata e shkallës së parë udhëzohet që të ndërmarrë veprime të caktuara për eliminimin e shkeljeve të përmendura si më lartë, në pajtim me dispozitat ligjore. Pas vërtetimit të gjitha fakteve dhe kryerjes së të gjitha veprimeve që i ka për obligim si gjykatë, e njëjta udhëzohet t'i kushtoj kujdes rregullimit të padisë në kuptim objektiv, ashtu që të kujdeset që mos të mbyllë shqyrtimin pa e përfunduar si çështje rregullimin e padisë, më pas t'i ofrojë mundësi palës së paditur të deklarohet lidhur me propozimin për ndryshim, në fund të merr vendim për lejimin ose jo të ndryshimit të padisë. Më tej, udhëzohet gjykata e shkallës së parë që të gjykoj ndaras kategorinë e dëmit që lidhet me zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm mjekësor me zvogëlim të aktivitetit punues, duke shqyrtuar ekspertizat veçmas për secilën kategori. Të kujdeset që nëse ka kërkesë për rentë, të vlerësoj drejtë ekspertizat mjekësore, të lëmisë së punës, aktuaristike, në mënyrë që përfundimi të rezultojë me gjendje faktike të vërtetuar drejtë. Të kujdeset që për kategorinë kompensuese shpenzime mjekësore të mjekimit, të administroj prova (sipas propozimit të ndërgjyqësve) që dëshmojnë lartësinë dhe nevojën për mjekimin e paditëses. Në fund, udhëzohet gjykata e shkallës së parë, që me rastin e përpilimit të aktgjykimit, t'i ketë parasysh kërkesat ligjore që rrjedhin nga dispozita e neni 160 të LPK-së (të hartoj dispozitivin e aktgjykimit në përputhje me par. 3 të nenit 160 të LPK-së, si dhe të paraqes arsyetimin në pajtim me parag.4 të këtij neni), ashtu që pas administrimit të provave të propozuara nga të dyja palët ndërgjyqëse dhe vlerësimit të arsyetuar detajisht të provave që i shqyrton dhe i administron, të vendosë për kërkesëpadinë e palës paditëse, në bazë të ligjit, përfshirë këtu edhe për shpenzimet e procedurës.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të nenit 194 dhe 195, paragraf 1, pika c) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL**  
**Ac.nr.32/2021, datë 07.04.2024**

**Kryetari i Kolegjit, Gjyqtari**  
**Dardan Kadolli**